



Vizitat në Medine

Ç'farë vizitohet dhe ç'farë nuk vizitohet në Medine

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد : أما بعد

Ai i cili udhëton për në Medine me qëllim vizite, duhet të dije se:

Udhëtimi për në Medine me qëllim vizite për të cilën ka argument dhe shpërblehesh për të, është vetëm ai udhëtim i cili bëhet me njetin për të vizituar xhaminë e Profetit ﷺ, dhe jo Medinen si qytet, dhe as vende dhe gjëra të tjera.

Thotë Profeti ﷺ:

لا تُشَدُّ الرحال إلا إلى ثلاثة مساجد، مسجد الحرام و مسجدني هذا و المسجد الأقصى

“Nuk merret udhëtim (dmth: mos udhëtoni) përveç se për në tre xhamia: për në xhaminë e shenjtë, në xhaminë time dhe në xhaminë Aksa.” [Buhariu dhe Muslimi]

Dijetarët thonë:

Nuk merret udhëtim - Mos udhëtoni.

- Ky hadith nxit që të udhëtohet për të vizituar këto tre xhami. Që do të thotë se shpërblehesh nëse udhëton me njetin për të vizituar këto tre xhami.
- Ky hadith përmend udhëtimin me qëllim vizitën e xhamisë së Profetit ﷺ dhe jo Medinen si qytet.

Prandaj kur thuhet:

Udhëtimi për të vizituar Medinen, do të thotë: udhëtimi për të vizituar xhaminë e Profetit ﷺ dhe jo Medinen si qytet. Prandaj edhe njeti duhet bërë me qëllim vizitën e xhamisë së Profetit ﷺ.

UDHËTIMI PËR TË VIZITUAR XHAMIA APO VENDE ME MENDIMIN SE ËSHTË E PËLQYER T'I VIZITOSH

Hadithi: *“Mos udhëtoni përveç se në tre xhamia..”*, ana e jashtme e tij na jep të kuptojmë se: nuk lejohet të udhëtohet për të vizituar ndonjë vend tjetër me pretendimin se është mirë të vizitohet ai vend, apo është e pëlqyer dhe ka shpërblim, përpos keto tre xhamia.

Në lidhje me kuptimin e këtij hadithi ka mospajtim ndërmjet dijetarëve:

- Disa dijetarë thonë se kuptimi i këtij hadithi është:
“Mirësia dhe vlera e plotë arrihet në këto tre xhamia, kur ti udhëton për t'u falur në to.”
Që do të thotë se lejohet udhëtimi për të vizituar xhamia të tjera, ama shpërblimi më i madh dhe më i plotë është udhëtimi për t'u falur në këto tre xhamia.
- Disa dijetarë të tjerë thonë: *“Në këtë hadith është për qëllim l'tikafi.”*
Dmth: nuk lejohet të udhëtohet për të bërë itikaf në ndonjë xhami përpos këtyre tre xhamive.
Ibn Haxheri [në Fet'h] thotë: ‘nuk di asnjë argument në lidhje me këtë mendim.’
- Disa të tjerë thonë: *“Ndalesa në këtë hadith lidhet vetëm me xhamiat.”*
Dmth: ndalohet të udhëtosh me qëllim për të vizituar ndonjë xhami, përpos këtyre tre xhamive.
Që do të thotë se nëse udhëton për të vizituar vende, si kodra Tur, apo shpella Hira, etj... lejohet.
Këta bazohen në një hadith:

((لا ينبغي للمصلي ان يشد رحاله الى مسجد تبغى فيه الصلاة غير المسجد الحرام و المسجد الأقصى و مسجدي))

“Nuk bën (nuk duhet) që namazliu të udhëtoj për te ndonjë xhami me qëllim që të falet aty, përpos në xhaminë e shenjtë, xhaminë Aksa dhe xhaminë time.”

Shejkh Albani (All-llahu e mëshiroftë) thotë: *“Fjala ‘për te ndonjë xhami’ nuk është e saktë. Ajo është shtesë e një prej transmetuesve, i cili kundërshton shtatë transmetuesit e tjerë të këtij hadithi, të cilët nuk e kanë përmendur këtë shtesë.”*

- Disa dijetarë tjerë thonë: *“Hadithi është i përgjithshëm dhe përfshin çdo udhëtim me të cilin synohet vizita e ndonjë vendi, apo xhamie, apo varr Profeti, apo vende ku kanë ndodhur ngjarje, si për shembull: malin Hira, apo kodra Tur, apo fushëbeteja e Bedrit, apo çfarë do tjetër, në formë madhërimi, ose për t'u falur aty, për kërkim bereqeti, apo me pretendimin se është mirë t'a vizitosh atë vend.” Ky mendim është më i sakti!*

Thotë Ibn Haxheri:

فقال الشيخ أبو محمد الجويني : يحرم شد الرجال الى غيرها بساهر هذا الحديث .

"Ka thënë Shejkh Ebu Muhammed El Xhuwejnij (Shejkh i Shafive, vdekur më 438 H): Ndalohet udhëtimi për në vende tjera (xhamia apo ç'farëdo) përpos tre xhamive, duke u bazuar në atë që kuptohet nga ana e jashtme (sipërfaqësore) e këtij hadithi. " [Fet'hul Bari]

Thotë Abdur-rahman El Mubarekfuri:

ظاهر الحديث هو العموم ، و أن المراد فيه : لا يجوز السفر إلى موضع للتبرك به و الصلاة فيه إلا إلى ثلاثة مساجد .

"Ajo që kuptohet nga ana sipërfaqësore (e jashtme) e hadithit është përgjithësimi (dmth: përfshin çdo vend) dhe se kuptimi i tij është: Nuk lejohet udhëtimi në një vend me qëllim kërkim bereqeti në atë vend, apo me qëllim që të falesh në atë vend, përveç se në tre xhamia. " [Tuhfetul Eh'uedhij]

Thot Ibn Tejmije: "Fjala e Profetit: **Mos udhëtoni përveç se në tre xhamia:**

- Ose ka për qëllim:

لا تشد الرجال الى مسجد إلا الى هذه الثلاثة .

"Nuk lejohet udhëtimi për të vizituar ndonjë xhami, përpos në këto tre xhamia."

Dmth: ndalesa është vetëm për xhamiat. Nuk lejohet udhëtimi për të vizituar ndonjë xhami, përpos tre xhamive.

- Ose është për qëllim

لا تشد الرجال الى مكان مطلق من الأمكنة التي تقصد و تُعَظَّم و يسافر لأجلها .

"Nuk lejohet udhëtimi në asnjë vend pa përjashtim, prej vendeve të cilat synohen dhe madhërohen, dhe udhëtohet për atje për shkak tyre. " (qoftë ajo xhami, apo varr, apo ç'farëdo.)

Ibn Tejmije (All-Ilahu e mëshiroftë) i qëndron mendimit së hadithi është i përgjithshëm. Thotë:

بخلاف السفر إلى البقاع المعظمة كطور موسى و قبور الأنبياء و الصالحين، فإن الصحابة و التابعين و الأئمة فهموا دخولها في هذا الحديث .

"Sahabët, Tabi'inët dhe Imamllarët, kanë kuptuar se udhëtimi për në vende të cilat madhërohen, si për shembull: të udhëtosh për të vizituar Turin e Musait (Alehis-selam) apo varret e Profetëve dhe njerëzve të devotshëm, përfshihet në këtë hadith."

[قاعدة عظيمة في الفرق بين العبادات أهل الإسلام و الإيمان و عبادات أهل الشرك و النفاق]

Thotë:

فلا ريب أنه إذا لم يشرع السفر إلى المساجد ، فلا يشرع إلى هذه بطريقة الأولى

"Nuk ka dyshim se përderisa nuk lejohet udhëtimi për të vizituar xhamia (përpos tre xhamive), atëherë ndalesa që të udhëtosh për të vizituar vende tjera është më parësore."

Thotë Shejkh Albani (All-llahu e mëshiroftë):

. لا تشد الرحال الى موضع من المواضع لقصد فضيلة ذلك المكان إلا هذه المساجد الثلاثة

" Nuk lejohet udhëtimi në një vend prej vendeve, me synim vlerën dhe mirësinë e atij vendi, përpos këto tre xhamia."

Shejkh Albani gjykon se hadithi është i përgjithshëm dhe përfshin udhëtimin në çdo vend prej vendeve ku mendohet se ka vlerë ai vend dhe është mirë të vizitohet.

Thotë San' ani:

. فيحرم السفر إلى غيرها كقبور الصالحين و المواضع الفاضلة

Është haram udhëtimi për në vende tjera (përpos tre xhamive) si për shembull: udhëtimi për të vizituar varret e njerëzve të devotshëm të mirë, apo vendeve të mira." [Et- Ten'uiir, Sherh el Xhami es-Sagiir]

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve siç e përmend Abdur-rahman bin Hasen në [Fethul Mexhid].

Ky është mendimi i Sahabëve dhe Tabi'inëve, siç thotë Ibn Tejmije.

Ky është mendimi i imamlarëve të kohëve tona, i shejkh Albanit ,Bin Bazit, Ibn Utthejmin.

S'ka dyshim se ky është mendimi më i saktë. Kjo sepse nuk gjejmë asnjë argument i cili e veçon, apo e kufizon vetëm me xhamiat.

Dhe duke qenë se nuk ka argument që e veçon, apo e kufizon ndalesën vetëm për xhamiat, atëherë është detyrë t'i përmbahemi anës së përgjithshme të tij, siç thotë rregulli:

'Teksti i përgjithshëm qëndron në të përgjithshmen e tij.'

(dmth: gjykojmë dhe veprojmë me të) **deri sa të vije një argument i cili e nxjerr nga e përgjithshmja e tij** (duke e veçuar, apo kufizuar me diçka të veçantë).

Thotë Shejkh Albani:

. لا دليل يخص الحديث بالمساجد، فالواجب البقاء على عمومته الذي ذهب اليه أبو محمد الجويني و من ذكر معه

"Nuk ka argument që e veçon (kufizon) hadithin vetëm me xhamiat. (Dmth: nuk ka argument që na tregon se hadithi ka për qëllim vetëm xhamiat dhe jo vendet tjera). Dhe në këtë rast (duke mos gjetur argument

që e veçon, atëherë) është detyrë qëndrimi në të përgjithshmen e tij, të cilën gjë e thotë edhe Ebu Muhammed el Xhuwejni e të tjerë që përmenden bashkë me të"

Sahabët dhe Tabi'inët e kanë kuptuar këtë hadith dhe e kanë interpretuar si hadith në të cilin ndalesa në të është e përgjithshme, dhe nuk kufizohet vetëm me udhëtimin për të vizituar xhamia të tjera, por përfshin çdo udhëtim për në çdo vend ku mendohet se është mirë të vizitohet.

Ka transmetuar Ibn Ebi Shejbeh nga Kazeah Ibn Jahja El Basrij i cili thotë:

عن قَزَعَةَ بن يحيى قال: أردت الخروج الى الطور، فسألت ابن عمر فقال: أما علمت أن النبي صلى الله عليه وسلم قال: لا تشد الرحال إلا الى ثلاثة المساجد، المسجد الحرام و مسجد النبي و المسجد الأقصى، دع عنك الطور فلا تأته.

"Doja të shkoja për në Tur (mali Tur në të cilin i ka folur All-Ilahu i Lartësuar Musait alejhi selam). Pyeta për këtë Ibn Umerin dhe ai më tha: A nuk e di se Profeti ﷺ ka thënë:

Nuk udhëtohet (dmth: nuk lejohet udhëtimi) përveç se në tre xhamia: Xhamia e Shenjtë, Xhamia e Profetit dhe Xhamia Aksa.

Lëre Turin, mos shko"

[E ka saktësuar Shejh Albani]

Ky transmetim tregon qartë se Ibn Umeri (shok i Profetit ﷺ) e ka kuptuar prej këtij hadithi se ndalesa në të është e përgjithshme. Ajo përfshin edhe udhëtimin për në vende tjera, vende të cilat mendohet se është mirë t'i vizitosh.

Ka transmetuar Imam Malik e të tjerë, nga Ebu Hurejra i cili thotë:

خرجت الى الطورفلقيت بُصْرَةَ بن أبي بُصرة الغفاري، فقال: من أين أقبلت؟ فقلت من الطور، فقال: لو أدركتك قبل أن تخرج إليه ... ما خرجت، سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: لا تُعْمَلِ المَطِيُّ إِلَّا الى ثلاثة مساجد

"Shkova në Tur ... (kur u ktheva) takova Besrah Ibn Ebi Besra. Më tha: prej nga po vjen? I thashë: nga Turi. Tha: sikur të arrija (të të takoja) ty para se të niseshe, nuk do shkoje. Kam dëgjuar të Dërguarin e All-Ilahut ﷺ të thotë:

Nuk udhëtohet (dmth: mos udhëto) përveç se për në tre xhamia.."

[Shejkh Albani thotë: transmetimi është Sahih (i saktë)]

Ky transmetim qartë tregon se Besrah (Shok i Profetit) e ka kuptuar se ky hadith është i përgjithshëm, dhe nuk ka për qëllim vetëm xhamiat, por edhe vende të tjera, të cilat mendohet se është mirë të udhëtohet për t'i vizituar ato.

Këtë kuptim ia miratoi edhe Ebu Hurejra, i cili nuk e kundërshtoi, gjë që tregon dakortësi.

Nuk dihet që të ketë prej Sahabëve t'a ketë kundërshtuar këtë. Madje ka që e përforcojnë këtë mendim.

Ka transmetuar Ibn Ebi Shejbe: “I thanë Umerit radijall-llahu anhu se disa njerëz shkojnë te pema tek e cila Sahabët i dhanë besën Profetit ﷺ (Bej'atu Rid'uan), Umeri urdhëroi të pritët.”

[Ibn Haxher thotë: zinxhiri është i saktë, po ashtu edhe shejkh Albani]

Tregon Ma'rur Bin Suwejd: “Dolëm (në udhëtim) me Umer Bin El Khattab. Gjatë rrugës shikuam një xhami (vendfalje). Disa njerëz sapo e shikuan, shpejtuan për tek ajo, për t’u falur aty.

Umeri tha: ç’farë kan ata (dmth: pse shpejtuan për te ajo)? I thanë: ajo është një xhami (vendfalje) në të cilën është falur i Dërguari i All-llahut.

Umeri tha: O ju njerëz! Ata që ishin para jush, devijuan dhe u shkatërruan, për shkak të pasimit (ndjekjes) si shembulli i kësaj (që po bëni ju, duke ndjekur vendet ku ka qëndruar apo ku është falur Profeti) dhe i bënin ato vendfalje.

Atë që e kap koha e namazit në atë vend (ku është falur Profeti) le të falet, e nëse jo, të vazhdoje udhëtimin. (mos të ndalet me qëllim që të falet në atë vend)

[E ka Saktësuar Ibn Tejmije ne El Mexhmu El Fetewa]

Kjo tregon se:

- Kur nuk lejohet të ndalosh në ato vende edhe kur të bie rruga rastësisht, atëherë udhëtimi kastile për t’a vizituar atë vend s’ka dyshim që është edhe më i ndaluar.
- Po ashtu prerja e pemës nga ana e Umerit, tregon se nuk lejohet të udhëtosh për tek ajo, sepse sikur t’u lejonte, Umeri nuk do urdhëronte prerjen e saj.

Duke u bazuar në këto që u përmendën, nuk ka dyshim se mendimi i saktë në lidhje me ndalesën në këtë hadith është mendimi i atyre që thonë se ndalesa në këtë hadith është e përgjithshme.

Duke qenë se ndalesa është e përgjithshme, atëherë:

1. Nuk lejohet të udhëtohet për të vizituar një xhami, qoftë ajo brenda shtetit tënd, apo jashtë shtetit. Thotë Shejkh Bin Bazi:

أما المساجد الأخرى فلا يشد الرجال لها

"Nuk lejohet të udhëtohet për të vizituar xhami tjera (përpos tre xhamive)."

2. Nuk lejohet të udhëtohet me qëllim që të vizitosh vende, qofshin ato vende ku kanë ndodhur gjëra të mëdha, si për shembull:

- Mali Tur, ku All-llahu i ka folur Musait.
- Apo Mali Hira, ku i është shpallur Profeti ﷺ.
- Apo shpella në të cilën u fsheh Profeti ﷺ bashkë me Ebu Bekrin.

- Apo të udhëtosh me qëllim që të vizitosh ndonjë varr Profeti, apo dijetari të njohur.
- Apo çfarë do vendi tjetër, duke pasur për qëllim mirësinë dhe vlerën e atij vendi, me nijetin dhe mendimin se është mirë të vizitohet ai vend.

Përveç tre vende, të cilat kanë vlerë dhe mirësi të madhe.

Në këto tre vende lejohet dhe është mirë për të udhëtuar te ato, me nijetin e arritjes së bereqetit dhe mirësisë së atyre vendeve. Dhe ato janë:

1. **Xhamia e Shenjtë** – namazi në të është sa njëqind mijë (100.000) namaze.
Disa mendojnë se në të gjithë Mekken namazi është sa 100,000 namaze. Kjo nuk është e vërtetë. Vetëm në xhaminë e shenjtë (xhaminë e Qabes) ka këtë vlerë namazi, dhe jo në xhamitë tjera. Madje as në hotelet afër Xhamisë.
2. **Xhamia Profetit** ﷺ - namazi në të është sa një mijë (1000) namaze.
3. **Xhamia Aksa** - namazi në të është sa dyqind e pesëdhjetë (250) namaze. [Albani]

Transmetimi që përmend se namazi në xhaminë Aksa është sa 500 namaze nuk është i saktë. [Albani]

Ndërsa xhamitë e tjera edhe pse në vetvete të gjitha kanë vlerë dhe mirësi, sepse janë vendet më të dashura të All-llahu, nuk lejohet të udhëtohet te asnjë prej tyre.

Të gjitha xhamitë e tjera në gjithë botën nuk kanë dallim njëra nga tjetra.

Dy rekate nafile në xhaminë e lagjes tënde janë të njëjtë si dy rekate në xhaminë Blu të Stambollit, apo në çdo xhami tjetër, përveç tre xhamive.

Thotë Ibn Tejmije:

"Nuk ka dyshim se kur udhëtimi për në xhamia nuk është i lejuar, ndalimi i udhëtimit për në vende tjera është edhe më parësor."

Duhet të dimë se përderisa Sheriati e ka ndaluar udhëtimin në çdo vend me qëllim adhurimi në atë vend, apo me qëllim për të kërkuar bereqetin në atë vend, apo me pretendimin se është mirë dhe e pëlqyer me e vizitu atë vend, atëherë kjo do të thotë se: nuk ka asnjë dobi shkuarja në ato vende.

Ajo që thonë disa: 'unë kur shkoj aty ndihem mirë, meditoj, më shtohet Iman', janë mashtrim i shejtanit.

Sikur të shtohet imani në ato vende, nuk do e ndalonte Sheriati, sepse Sheriati urdhëron dhe nxit për çdo vepër dhe punë që e shton Imanin.

UDHËTIMI PËR QËLLIME TJERA

Nëse udhëton për qëllime tjera si:

- Për të kërkuar dituri.
- Apo udhëtim për punë ose tregti.

- Apo udhëtim për të parë mënyrën se si është ndërtuar filan xhami, që t'a ndërtosh një të tillë në vendin tënd.
- Apo udhëtim për të vizituar njerëz të afërm, shokë, vëllezër musliman dhe miq.
- Për të njohur historinë e një populli.
- Për turizëm etj.

Udhëtimi për këto gjëra dhe të tjera si këto nuk futet te ndalesa në hadith, siç thonë dijetarët.

AI QË UDHËTON PËR NË MEDINE, NIJETI I TIJ DUHET TË JETË VIZITA E XHAMISË SË PROFETIT ﷺ

Ai që udhëton për të vizituar Medinen, njeti i tij duhet të jetë, udhëtim për të vizituar xhaminë e Profetit ﷺ.

Nuk lejohet të udhëtosh në Medine me qëllimin dhe nijetin për të vizituar varrin e Profetit ﷺ, apo xhaminë Kuba. Apo xhamitë e tjera, apo Uhudin, apo varrezat e Bakia-s, apo shtatë xhamitë etj.. të kësaj natyre.

Nëse udhëton në Medine për të arritur prej mirësive që ajo ka, atëherë nijeti yt duhet të jetë që të vizitosh xhaminë e Profetit ﷺ. Në xhaminë e Profetit ﷺ është mirësia, vlera dhe bereqeti i atij vendi, të cilat arrihen prej namazit që fal aty, prej adhurimeve në përgjithësi që kryen aty dhe prej dijes që përfiton në xhaminë e tij ﷺ.

Dhe pas xhamisë së Profetit ﷺ që është kryesorja dhe qëllimi i udhëtimit, arrin edhe disa mirësi të tjera shtesë, nëse viziton varrin e Profetit ﷺ, si dhe nëse viziton disa vende të cilat i ka vizituar Profeti ﷺ.

UDHËTIMI NË MEDINE ME QËLLIM PËR TË VIZITUAR VARRIN E PROFETIT ﷺ

Disa udhëtojnë për në Medine me nijetin që të vizitojnë varrin e Profetit ﷺ.

Udhëtimi për në Medine me qëllimin kryesor për të vizituar varrin e Profetit ﷺ nuk lejohet!

Thotë Ibn Tejmije (All-llahu e mëshiroftë):

فلا يقصد السفر إلى القبر دون المسجد إلا جاهل

"Udhëton me qëllim për të vizituar varrin e Profetit dhe jo xhaminë, vetëm ai që është injorant."

Thotë në [Mexhmu el Fetawa]:

و أما إذا كان قصده بالسفر زيارة قبر النبي دون الصلاة في مسجده فهذه المسألة فيها خلاف ، فالذي عليه الأئمة و أكثر العلماء : أن هذا غير مشروع

"Nëse qëllimi i udhëtimit të tij është që të vizitoj varrin e Profetit, jo xhaminë, për këtë ka mospajtim ndërmjet dijetarëve. Imamllarët dhe shumica e dijetarëve thonë: Kjo nuk është e lejuar."

Thotë:

بل نفس السفر لزيارة قبر من القور منهي عنه عند جمهور العلماء

"Udhëtimi me qëllim për të vizituar një varr prej varreve, është i ndaluar sipas mendimit të shumicës së dijetarëve."

Thotë Shejkh Bin Bazi (All-llahu e mëshiroftë):

لا يجوز السفر بقصد زيارة قبر النبي صلى الله عليه وسلم أو قبر غيره من الناس في أصح قولي العلماء .لقول النبي صلى الله عليه وسلم ((....لا تشد الرجال إلا إلى ثلاثة مساجد))

"Nuk lejohet udhëtimi me qëllim për të vizituar varrin e Profetit ﷺ, apo varrin e dikujt tjetër, sipas mendimit më të saktë prej dy mendimeve të dijetarëve. Duke u bazuar në fjalën e Profetit, ku thotë:

Nuk udhëtohet (dmth: nuk lejohet udhëtimi) përveç për në tre xhamia.."

Thotë Ibn Uthejmini (All-llahu e mëshiroftë):

فلا يجوز أن يشد الإنسان الرحلة إلى زيارة قبر النبي

"Nuk i lejohet njeriut të udhëtoje me qëllim që të vizitoje varrin e Profetit ﷺ."

Kështu thonë edhe shejkh Albani, Feuzani, Abbadi, etj.

Nëse ata që udhëtojnë me njetin për të vizituar varrin e Profetit, udhëtojnë me qëllimin për t'i dhënë selam, lodhen dhe shpenzojnë kot.

Thotë Ibn Uthejmini:

"Personi i cili udhëton për të vizituar varrin e Profetit, për t'i dhënë selam, pse lodhet dhe shpenzon (dhe bën diçka të ndaluar)? Kudo që të jesh, ço selam për Profetin, dhe selami yt i mbërrin atij menjëherë."

Profeti ﷺ ka thënë:

((أَنَّ لِلَّهِ مَلَائِكَةً سَيَّاحِينَ فِي الْأَرْضِ، يُبَلِّغُونِي عَنْ أُمَّتِي السَّلَامَ))

[رواه النسائي و أحمد و صحيحه الالباني]

قال المظهري :يعني :إن الله أرسل ملائكة على وجه الأرض حتى يخبروني عن من صلى أو سلم علي

.قال القاري ((ان لله ملائكة))اي :جماعة منهم

((...))سياحين في الارض ((أي :سيارين بكثرة في ساحة الأرض

“All-llahu dërgon grup Melaikesh të cilët ecin vazhdimisht në tokë dhe më përcjellin selamet e umetit tim.”

Dmth: ata ecin kudo ku ka besimtarë dhe kur ata dëgjojnë se dikush i jep selam Profetit, ata ia përcjellin Profetit selamin e atij personi menjëherë.

DISA ARGUMENTE TË ATYRE QË E LEJOJNË UDHËTIMIN ME QËLLIM VIZITËN E VARRIT TË PROFETIT ﷺ

Ata të cilët e lejojnë udhëtimin me qëllim për të vizituar varrin e Profetit ﷺ argumentohen me disa hadithe. Prej tyre:

من زارني وجبت له شفاعتي

“Kush viziton varrin tim e meriton ndërmjetësimin tim.”

Hadithi është i shpikur, siç thot Ibn Tejmije, po ashtu edhe Albani

Thotë Ibn Tejmije:

أحاديث زيارة قبره صلى الله عليه وسلم كلها ضعيفة، لا يعتمد على شيء منها في الدين

"Hadithet që flasin në lidhje me vizitën e varrit të Profetit, janë të gjitha të dobëta."

[Mexhmu El Fetawa 1/234]

Po ashtu bazohen në atë ç'farë tregohet se Bilali radijall-llahu anhu ka parë në ëndërr Profetin ﷺ, dhe Profeti i ka thënë: “A nuk ka ardhur koha të më vizitosh o Bilal?

Dhe Bilali udhëtoi për në Medine, për të vizituar varrin e Profetit.

Thotë ibn Haxheri në [Lisanul Mizan]: *"Kjo histori (e Bilalit) duket qartë se është e shpikur."*

Ndërsa sa i përket argumentimit me fjalën e Profetit “vizitoni varret” argumentimi me këtë hadith nuk është i saktë, sepse:

Fjala e Profetit ‘vizitoni varret’:

1. Nuk do të thotë: udhëtoni për të vizituar varret.
2. Kjo kërkesë profetike mund të realizohet në vendin ku je, duke qene se çdo vend ka varrezat e veta, kështu që nuk është e nevojshme të udhëtosh për të realizuar këtë kërkesë profetike.

UDHËTIMI ME QËLLIMIN PËR TË VIZITUAR XHAMINË KUBA

Ka disa të cilët udhëtojnë për në Medine me qëllimin kryesor që të vizitojnë xhaminë Kuba, për të falur dy rekate të cilat kanë shpërblimin e umres.

Ky udhëtim me këtë qëllim nuk është i lejuar, ashtu sikurse udhëtimi për të vizituar varrin e Profetit ﷺ.

Sepse hadithi **“Nuk lejohet udhëtimi përveç në tre xhamia..”** siç përmenda më lart, ndalon udhëtimin për te xhamitë e tjera, dhe në këtë ndalesë futet edhe xhamia Kuba.

Thotë Ibn Tejmije:

بل لو سافر الى قباء من دويرة أهله لم يجز، و لكن لو سافر الى المسجد النبوي ثم ذهب منه الى قباء فهذا مستحب ، كما يستحب زيارة قبور أهل البقيع و شهداء أحد.

"Nëse udhëton nga shtëpia e tij për në xhaminë Kuba, nuk lejohet.

E nëse udhëton për në xhaminë e Profetit, pastaj nga aty shkon për te xhamia Kuba, kjo është e pëlqyer, ashtu sikurse është e pëlqyer vizita e varreve të Baki-es dhe dëshmorëve të Uhudit."

Pra, udhëtimi për të vizituar Medinen duhet të jetë me nijetin dhe qëllimin kryesor për të vizituar xhaminë e Profetit ﷺ. Dhe jo me qëllimin për të vizituar varrin e Profetit, apo Xhaminë Kuba , apo xhamitë tjera në Medine, apo për të shkuar në Uhud.

Nëse pas qëllimit kryesor që është vizita e xhamisë së Profetit, bën nijetin edhe për të vizituar varrin e Profetit, xhaminë Kuba, dhe dëshmorët e Uhudit lejohet.

Thotë Bin Bazi:

فتدخل زيارة القبر الشريف و قبر أبي بكر و عمر و الشهداء و أهل البقيع تبعاً لذلك، و إن نواهما جاز ؛ لأنه يجوز تبعاً ما لا يجوز استقلالاً.

"Vizita e varrit të Profetit, të Ebu Bekrit dhe Umerit, dëshmorëve të Uhudit dhe varreve të Baki-as futet si pasuese (e nijetit që është vizita e xhamisë së Profetit). Nëse bën nijet për t'i vizituar edhe ato, lejohet.

Lejohet në formë pasimi (dhe ndjekje), ajo ç'farë nuk lejohet në formë të pavarur (të veçantë)."

Nijeti në formë të pavarur dhe të veçantë në këtë rast, është nijeti dhe qëllimi kryesor për të cilin udhëton, që është vizita e xhamisë.

Nëse këtë nijet (qëllim kryesor) e pason me mendimin dhe nijetin që kur të vizitoj xhaminë e Profetit, do vizitoj edhe varrin e Profetit dhe xhaminë Kuba, lejohet.

Ç'FARË PËLQEHET TË VEPROJMË KUR TË VIZITOJMË XHAMINË E PROFETIT ﷺ

Vizita e xhamisë së Profetit është qëllimi i udhëtimit për në Medine, për atë i cili udhëton për të vizituar Medinen.

Gjëja e parë që duhet të bëjë personi pasi të akomodohet në hotel është: të marre abdes dhe të shkoje në xhaminë e Profetit.

Të futet me këmbën e djathtë.

Të thotë duan e hyrjes në xhami.

Duaja e hyrjes në xhami

اللهم صل على محمد و سلم.

ALL-LLAHUMME SAL-LI ALA MUHAMMEDIN UE SEL-LIM

اللهم افتح لي أبواب رحمتك

ALL-LLAHUMME IFTAH LI EB'UEBE RAHMETIK.

أعوذ بالله العظيم و بوجهه الكريم و سلطانه القديم من الشيطان الرجيم.

EUUDHU BIL-LAHIL ADHIIM UE BI UEXHHIHIL KERIIM UE SULTANIHIL KADIIM MESH- SHEJTANIR RAXHIIM.

Ka ardhur në hadith se: “Kush e thotë këtë dua kur futet në xhami, thotë shejtani: ky njeri është i mbrojtur nga une gjithë ditën.” [Ebu Daudi, Shejkh Albani thotë: Sahih]

Të fale dy rekate në xhaminë e Profetit ﷺ, apo më shumë, nëse është kohë kur lejohet namazi nafile.

Nëse është kohë kur nuk lejohet namazi nafile, atëherë të fale vetëm dy rekate Tehij-jatul Mesxhid, por jo më shumë.

Thotë Shejkh Bin Bazi:

من السنة لمن زار المدينة أن يقصد المسجد و يصلي فيه ركعتين أو أكثر و يكثر من الصلاة فيه و يكثر من ذكر الله و قراءة القرآن ، و حضور حلقات العلم ، و إذا تيسر له أن يعتكف ما شاء الله فهذا حسن.

"Është sunnet për atë që viziton Medinen të synojë xhaminë e Profetit dhe të fale aty dy rekate apo më shumë.

Të shtojë sa më shumë faljen në të, të shtojë dhikrin dhe leximin e kuranit, dhe të prezantojë në mësimet që bëhen në xhami, e nëse mundet të bëjë Itikaf. Kjo është gjë e mirë."

NAMAZI NË RAUDA

(në kopshtin e xhennetit)

Thotë Profeti ﷺ:

(مَا بَيْنَ بَيْتِي وَمِنْبَرِي رَوْضَةٌ مِنْ رِيَاضِ الْجَنَّةِ، وَمِنْبَرِي عَلَى حَوْضٍ) (رواه البخاري) 1196 (ومسلم 502).

"Ndërmjet shtëpisë sime dhe minberit tim (vendi ku mban hytben) është kopësht prej kopshteve të xhennetit, ndërsa minberi im është mbi Haud (në ditën e gjykimit)." [Buhariu dhe Muslimi]

Thotë Imam Neueuiju:

النووي رحمه الله: "ذكروا في معناه قولين

أحدهما: أن ذلك الموضع بعينه يُنقل إلى الجنة

: /والثاني: أن العبادة فيه تؤدي إلى الجنة. "انتهى من "شرح مسلم" 9"

"Janë përmendur në lidhje me kuptimin e hadithit dy mendime:

- ky vend do të jetë në xhennet. (dmth: do merret dhe do vendoset në xhennet).
- adhurimi aty të shpie në xhennet." [Sherh Muslim 9/161]

Të njëjtën gjë thotë edhe Ibn Haxheri në [El fet'h 4/100].

Shumë dijetarë (Bin Bazi, Ibn Uttejmini etj) thonë se pëlqehet të falësh namaz nafile në Raudah. Dmth: t'a veçosh nga vendet e tjera në xhami.

Thotë Ibn Tejmije (All-llahu e mëshiroftë):

"Një grup dijetarësh e konsiderojnë të pëlqyer namazin në Raudah"

Ndërsa disa dijetarë (prej tyre shejkh Albani) thonë se nuk ka argument të veçohet Raudah nga pjesët e tjera të xhamisë.

Thotë shejkh Albani (All-llahu e mëshiroftë):

...الصلاة في الروضة ليس لها فضيلة خاصة

وقال: أما الصلاة في الروضة و التهجم الذي يتهجم الناس بسبب هذه الدعوة، أنا ما أجد له مبررا في الشريعة

"Namazi në Raudah nuk ka ndonjë vlerë të veçantë (në krahasim me vendet tjera të xhamisë). Sa i përket namazit në Raudah dhe kësaj vërsulje të njerëzve (që të falen aty) për shkak të këtij pretendimi (se ka vlerë më të madhe namazi aty) unë nuk gjej argument në Sheriat."

Dmth: nuk ka argument që tregon se namazi në Raudah është më i mirë se në vendet tjera të xhamisë.

Nuk ka argument që tregon se Profeti ﷺ dhe shokët e tij, e veçonin këtë vend për namaz apo dua.

Kjo që thotë Shejkh Albani është më e përafërta, sepse fakti që ai vend është ndryshe nga vendet e tjera nuk do të thotë se adhurimi ka vlerë më të madhe.

Që të thuash se ka vlerë më të madhe dhe shpërblimin e ka më të madh, duhet medoemos argument prej atij që vendos shpërblimet, që është All-llahu i Lartësuar.

NJË SHPJEGIM I SHKURTËR NË LIDHJE ME I'TIKAFIN

I'TIKAFI është i pëlqyer, nuk është detyrë. I'TIKAFI bëhet në xhami.

Shumica e dijetarëve thonë: lejohet në çdo xhami.

Një pjesë e dijetarëve thonë: nuk lejohet përveç se në tre xhamiat: në xhaminë e Shenjtë, në xhaminë e Profetit ﷺ dhe në xhaminë Aksa. Duke u bazuar në hadithin:

لا اعتكاف الا في ثلاثة مساجد المسجد الحرام و المسجد الأقصى و مسجد رسول الله صلى الله عليه وسلم

"Nuk ka I'tikaf përpos në tre xhamia: në xhaminë e shenjtë, në xhaminë Aksa dhe në xhaminë e të Dërguarit të All-llahut" [Sahih - Albani]

I'TIKAFI lejohet në çdo muaj të vitit, jo vetëm në Ramazan.

Thotë Shejkh Bin Bazi dhe Albani: *"I'tikafi lejohet në çdo kohë të vitit."*

Për këtë ka unanimitet, siç thotë Ibn Abdul Berr, Ibn Muflih, Er-Ramlij, El Buhuuti.

Profeti ﷺ ka bërë I'tikaf edhe në muajin Sheuual. [Buhariu dhe Muslimi]

Shejkh Ibn Uttejmin thotë:

أما في غير رمضان فإن الاعتكاف ليس بمسنون

"I'tikafi jashtë Ramazanit nuk është sunnet (dmth: nuk është i ligjëruar)."

Ndërsa I'tikafin e Profetit ﷺ në Sheual e justifikon me atë se Profeti atë vit nuk bëri I'tikaf në Ramazan dhe prej zakonisht të tij ka qenë që kur bënte një adhurim, nuk e linte më. Atë vit nuk beri I'tikaf në Ramazan dhe e plotësoi në Sheual.

Me fjalën e tij *‘Nuk është sunnet, nuk është e pëlqyer’* ndoshta shejkh Ibn Uthejmini ka për qëllim që nuk është prej sunnetit (dmth: nuk e ka bërë Profeti), ama për t’u lejuar, lejohet. Sepse shumë dijetarë thonë: *"ka unanimitet që lejohet."* E nëse unanimiteti është i saktë, atëherë nuk lejohet të kundërshtohet.

I'TIKAFI nuk ka kufizim në ditë.

Nuk ka argument që tregon se sa është minimalja e ditëve, apo maksimalja e ditëve që mund të bësh i'tikaf. Sa i përket Kufirit Maksimal nuk ka kufi: mund të bësh i'tikaf sa të duash dhe për këtë ka unanimitet. E përcjell këtë unanimitet imam Neueuiju në [Sherh Muslim] dhe Ibn El Mulak-kin në [El la'lam].

Ndërsa sa i përket Kufirit Minimal ka mospajtim.

Shumica e dijetarëve [siç e përmend këtë Ibn Abdul Ber-r] thonë: *"Nuk ka kufi minimal."* Dmth: të lejohet edhe disa orë gjatë ditës, apo natës. Ky është mendimi i Hanefive, Shafive, dhe disa dijetarëve Hanbeli. Ky është mendimi i Ibn Hazmit, Sheukanit. Ky është mendimi i Bin Bazit.

Malikitë thonë: *"Më e pakta është një ditë dhe një natë."*

Ebu Hanife thotë: *"Nuk ka i'tikaf më pak se një ditë."* [Ibn Hazmi në Muhal-la]

Shafitë dhe Hanbelitë thonë: *"Më e mira është të mos jetë më pak se një ditë."*

Ibn Uthejmini thotë: *"i'tikafi është ditën dhe natën, jo vetëm ditën."*

Ndoshta më e përafërta është: jo më pak se një ditë e plotë, apo një natë e plotë.

Duke u bazuar në hadithin ku Umeri radiAll-llahu anhu i tha Profetit ﷺ:

"O i Dërguar i All-llahut! Në xhahilijet jam zotuar të bëj i'tikaf një natë në xhaminë e shenjtë. Profeti i tha: Zbatoje zotimin tënd." [Bukhari & Muslimi]

Ndërsa sa i përket mendimit se bën të bësh i'tikaf qoftë edhe një orë të ditës, madje thonë: kur të shkosh te xhamia për të falur namazin, apo për diçka tjetër, bëj nijet për i'tikaf aq kohë sa do qëndrosh në xhami; Kjo fjalë nuk është e saktë, sepse nuk ka argument. Dhe si e tillë nuk lejohet siç thotë Ibn Tejmije. [Albani në librin Namazi i natës në Ramazan].

Kështu thotë edhe vet shejkh Albani. Kështu thotë edhe Ibn Uthejmini.

Sa i përket kohës kur hyn në i'tikaf

Ai që ecën me mendimin se bën të bësh i'tikaf një ditë pa natën e saj, apo një natë pa ditën e saj. Nëse do të bëjë i'tikaf vetëm një natë, pa ditën e saj, koha është prej para perëndimit deri pas agimit. [Ibn Hazmi]

Nëse bën i'tikaf vetëm një ditë, pa natën e saj, koha është prej para agimit deri pas perëndimit të diellit. [Sipas Ibn Hazmit]

Por më e sakta është: të futet pasi të fale namazin e sabahut.

Profeti ﷺ kur hynte në i'tikaf, hynte pas namazit të sabahut.

Thotë Aisheh radijall-llahu anhe:

كان رسول الله صلى الله عليه وسلم إذا أراد أن يعتكف صلى الفجر ثم دخل معتكفه

"I Dërguari i All-llahut kur donte të hynte në i'tikaf, falte sabahun, pastaj hynte në vendin e i'tikafit tij."

[MUSLIMI]

Agjërimi për atë që bën i'tikaf

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me agjërimin e atij që do të bëjë i'tikaf.

Thotë shejkh Albani në librin e tij [Kijamu Ramadan]: *"i'tikafi shoqërohet me agjërim. Nuk ka i'tikaf pa agjërim. Ai që do të bëjë i'tikaf duhet të jetë agjërueshëm."*

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Ky është mendimi i Ibn Tejmijes. Kjo sepse nuk është transmetuar që Profeti të ketë bërë i'tikaf pa qenë agjërueshëm.

Aishja radiAll-llahu anhe thotë: *"nuk ka i'tikaf pa agjërim."* [Albani në librin e tij Kijamu Ramadan] (me kuptim, jo fjalë për fjalë).

Ibn Umeri dhe Ibn Abassi kanë thënë: *"Nuk ka i'tikaf përveç se me agjërim."*

Disa dijetarë thonë se agjërimi nuk është kusht.

Shejkh Bin Bazi thotë: *"nuk është kusht agjërimi në i'tikaf."*

Pra, nëse viziton xhaminë e Profetit ﷺ, është e pëlqyeshme të bësh Itikaf, qoftë edhe një ditë. Më e përafërta është se edhe duhet agjëruar.

Nëse do të besh i'tikaf vetëm natën.

Kur të hysh në i'tikaf para perëndimit, të jesh agjërueshëm atë ditë, kështu që konsiderohesh që ke hyrë në i'tikaf agjërueshëm. Iftarin e çel në xhami. Nëse nuk ke ç'farë të hash, lejohet me dal me ble diçka dhe kthehesh menjëherë në xhami. [Ibn Utthejmini]

VIZITA E VARRIT TË PROFETIT ﷺ

Vizita e xhamisë së Profetit ﷺ është qëllimi dhe nijeti i udhëtimit në Medine. Pasi falemi në xhami, dy rekate apo më shumë, në varësi të kohës kur mbërrin në xhami, pëlqehet të vizitohet varri i Profetit ﷺ dhe dy shokëve të tij Ebu Bekrit dhe Umerit.

Thotë Shejkh Bin Bazi:

زيارة قبر النبي صلى الله عليه وسلم سنة وقرينة.

"Vizita e varrit të Profetit ﷺ është sunnet dhe afrim tek All-llahu".

Thotë Shejkh Ibn Uthejmini:

إن زيارة قبر النبي صلى الله عليه وسلم من الأمور المستحبة.

"Vizita e varrit të Profetit ﷺ është prej punëve të pëlqyera."

Edukata e vizitës së varrit të Profetit ﷺ

Kur të nisemi për te varri i Profetit ﷺ dhe i dy shokëve të tij, pasi futemi në xhami, duhet të ecim me qetësi, mos të shtyjme, mos të bëjmë muhabet me njeri. Nëse na duhet të shpjegojmë diçka, atëherë flasim me zë të ulët, pasi nuk duhet ngritur zëri. Mos të përdorim telefonin. Jo Fotografi. Jo video.

Dhënia Selam

Kur të gjendemi përballë me varrin e Profetit ﷺ, i japim selam dhe themi:

ES-SELAMU ALEJKE JA RASULALL-LLAH.

Thotë Shejkh Bin Bazi:

Pastaj spostohesh pak nga e djathta dhe i jep selam Ebu Bekrit. Thua:

ES-SELAMU ALEJKE JA EBA BEKR.

Pastaj spostohesh pak nga e djathta dhe i jep selam Umerit. Thua:

ES-SELAMU ALEJKE JA UMER!

Dhe del nga xhamia.

Shejkh Albani thotë: "Vetëm selam ju jep, kaq. Nuk bën të shtosh diçka më shumë se selami. Kështu ka vepruar Ibn Umeri. Ai vetëm selam iu ka dhënë, nuk ka shtuar diçka tjetër." [Albani]

Disa dijetarë thonë: "lejohej të shtosh sipër selamit, si dhe lejohej të bësh dua." Kjo nuk është e saktë, pasi nuk e kanë vepruar shokët e Profetit ﷺ, siç thotë Shejkh Albani. Bërja me shenjë me dorë apo ngritja e dorës kur japim selam nuk bën, pasi nuk ka argument. [Albani, Ibn Uthejmini, Feuzani]

Vendosja e duarve në gjoks kur u japim selam, nuk bën, pasi nuk ka argument. Disa e përkulin kokën, por kjo nuk lejohet, pasi përkulja është vetëm për All-llahun e Lartësuar.

Dhënia selam është vetëm një herë

Dhënia selam është një herë: ditën kur mbërrin në Medinë, falesh në xhami, shkon te varri dhe u jep selam. Nuk ka argument që për sa ditë të jesh në Medinë mund të shkosh t'u japësh përsëri selam. Nuk e kanë vepruar shokët e tij. [Albani, Ibn Uttejmini Feuzani]

Dhënia selam Profetit ﷺ te varri i tij kur të largohesh nga Medina

Ka dijetarë të cilët thonë: *“Bën t'i japësh selam Profetit ﷺ te varri i tij kur do të udhëtosh (kjo është për banorët e Medines).”* Unë personalisht nuk di argument për këtë.

Disa dijetarë thonë: *“Lejohet edhe për të huajt. (dmth për ata që kanë ardhur për të vizituar xhaminë e Profetit ﷺ. Lejohet për ta që t'i japin selam Profetit ﷺ te varri i tij, kur duan ta lejnë Medinen).”*

Unë personalisht nuk di argument për këtë.

All-llahu e di më së miri.

Ti lesh porosi dikujt që shkon në Medinë për t'i dhënë selam Profetit ﷺ nga ana jote

Disa dijetarë e lejojnë këtë. E vërteta është se nuk ka argument. Nuk e ka bërë asnjë nga Sahabët dhe të parët tanë të mirë. Kështu thotë Shejkh Albani, Bin Bazi, Lexhnja, Ibn Uttejmini etj.

Ajo që përmendet nga Umer bin Abdul Aziz është se ai ka dërguar dikë nga Shami për në Medinë me i dhënë selam Profetit nga ana e tij. Kjo nuk është e saktë. E ka përmendur këtë Ibnul Xheuzi, por pa zinxhir transmetimi.

VIZITA E XHAMISË KUBA

Pëlqehet vizita e xhamisë Kuba, për t'u falur në të. Thotë Profeti ﷺ:

((من تطهر في بيته ثم أتى مسجد قباء فصلى فيه صلاة كان له كأجر عمرة))

“Kush pastrohet në shtëpinë e tij (dmth: merr abdes, apo tejemum ai i cili nuk mundet me marr abdes), pastaj vjen në xhaminë Kuba dhe fal aty namaz, ka shpërblim si shpërblimi i Umres.”

[Ibn Maxhe, Albani thotë: Sahih]

و قال ((من توضأ في بيته ثم أتى مسجد قباء لا يريد إلا الصلاة فيه كان كعمرة))

“Kush merr abdes në shtëpinë e tij dhe pastaj vjen në xhaminë Kuba me qëllimin për të falur namaz, ka shpërblimin e Umres.” [Albani thotë: Sahih]

قال ((الصلاة في مسجد قباء كعمرة))

“Namazi në xhaminë Kuba është si Umre. (dmth: ka shpërblimin e Umres).”

[Tirmidhi, Ibn Maxhe, Albani thotë: Sahih]

Namazi këtu, është për qëllim çdo lloj namazi: nafile (dy rekat apo më shumë), ose namazi farz.

Thotë Menaui: fjala e Profetit “**Namazin**” përfshin farzin dhe nafilen.

Dmth: nëse vjen në kohë të namazit farz, dhe fatesh, të jepet shpërblim si shpërblimi i Umres.

Nëse vjen në xhaminë Kuba jo në kohë namazi farz, dhe fal dy rekate nafile, apo më shumë, merr shpërblim, si shpërblimi i Umres.

Sado rekate që të falësh, dy apo katër, apo namaz farz, me ato është për qëllim ‘**Namazi**’ në hadith.

Disa mendojnë se për çdo dy rekate merr shpërblim nga një Umre. Dmth: po fale katër rekate, ke dy Umre. Kjo nuk është e saktë. [Shejkh Sulejman Ruhejli]

Nuk ka namaz të veçantë që falet në xhaminë Kuba

Për shembull: nëse mbërrin në xhaminë Kuba në kohën kur po falet farzi, dhe futesh me imamin për të fal farzin, kjo mjafton. E ke marr shpërblimin që përmendet në hadith, insha All-llahu.

Dhe nuk bën që pasi të falësh farzin, të ngrihesh dhe të falësh dy rekate për xhaminë Kuba.

Kjo nuk bën, sepse nuk ka namaz të veçantë për xhaminë Kuba.

Qëllimi i hadithit është që personi të shkojë në xhaminë Kuba kastile (enkas) për tu falur. Nëse fal farzin, mjafton. E nëse nuk është kohë farzi, fal dy rekate nafile dhe mjafton. Apo fal Tehij-jatul Mesxhid dhe e merr shpërblimin insha All-llahu.

Nuk ka namaz të veçantë për xhaminë Kuba. [Shejkh Sulejman Ruhejli]

Kujdes!

“Mos të shkohet në xhaminë Kuba në kohët kur ndalohet namazi nafile.” [Shejh Salih Suhejmi, Sulejman Ruhejli]

Kohët ku ndalohet namazi nafile janë tre kohë:

- Prej kur falet namazi i sabahut dhe deri sa të ngrihet dielli një shtizë, për afërsisht 20 minuta pas lindjes reale të diellit dhe jo me kalendare.
- Prej kur të arrijë dielli në kupën e qiellit e deri sa të kalojë nga ana e perëndimit, për afërsisht 20 minuta para namazit të drekës.
- Prej kur të fillojë dielli të zverdhët e deri sa të perëndoje, për afërsisht një orë para perëndimit, por kjo varet edhe nga stinët.

Disa dijetarë thonë prej pas lkindie deri në perëndimin e diellit.

Mendimi i parë është më i përafërti.

Përpos këtyre tre kohëve në të cilat ndalohet namazi vullnetar, në kohë tjera lejohet kur të duash.

Më e mira është që të shkojë në xhaminë Kuba kur nuk është kohë e namazit Farz. Ashtu që mos të humb namazin me xhemat në xhaminë e Profetit ﷺ.

Ndoshta koha më e mirë është koha e paradites, duke u bazuar në atë që transmeton Bukhari nga Ibn Umeri i cili thotë:

كان لا يصلي من الضحى إلا يومين ، يوم يقدم بمكة فإنه كان يقدمها ضحى فيطوف بالبيت ثم يصلي ركعتين خلف مقام ، و يوم يأتي))
...مسجد قباء. فإنه كان يأتيه كل سبت

“Profeti nuk falte namaz paradite, përpos në dy ditë.

1. Ditën kur mbërrinte në Mekke dhe në Mekke mbërrinte paradite. Bënte Tauaf dhe pastaj falte dy rekate pas Mekamit.
2. Ditën kur vinte në xhaminë Kuba, ai vinte aty çdo javë..” [Buhariu]

Kushtëzohet marrja e abdesit në shtëpi ose hotel dhe të dalësh enkas për në xhaminë Kuba

Disa dijetarë, prej tyre Bin Bazi, thonë: që të arrish këtë shpërblim duhet të marrësh abdes në shtëpi, apo në hotel enkas për të shkuar në xhaminë Kuba.

Fjala e Bin Bazit :

... هذا الفضل ذكره لمن يتطهر من بيته و يخرج قاصدا للصلاة في قباء يحصل له هذا الأجر

، إنما يحصل هذا لمن تطهر في بيته و خرج من بيته قاصدا للصلاة في مسجد قباء، كما كان النبي يفعل، عليه الصلاة والسلام

اما الصلاة فيه من غير قصد من البيت ، بل مر و صلى به أو كان من جيرانه و صلى فيه الفروض يرجى له خير عظيم لكن لا يتوفر فيه ما قاله النبي صلى الله عليه وسلم الا بالشروط التي قالها

"Këtë mirësi (shpërblim) e arrin ai i cili pastrohet (merr abdes, apo tejemum ai qe nuk ka mundësi abdesin) në shtëpinë e tij (apo në hotel) dhe del me qëllim për të shkuar në xhaminë Kuba për t'u falur.."

Ama nëse je në xhaminë e Profetit ﷺ dhe thua: me këtë rrugë po shkoj në xhaminë Kuba; apo je në treg dhe thua me këtë rrugë po shkoj në xhaminë Kuba, kjo nuk pranohet dhe nuk e merr shpërblimin.

Duhet enkas, me marr abdes nga hoteli apo vendi ku rri dhe të nisesh për në xhaminë Kuba. Këtë mendim e ka edhe shejkh Albani.

Disa dijetarë thonë se nuk është kusht. Unë personalisht anoj te ajo që është kusht, duke u bazuar te kuptimi i jashtëm i hadithit.

Sunneti është një herë në javë

Thotë Ibn Umeri:

((كان النبي صلى الله عليه وسلم يأتي مسجد قباء كل سبت ماشيا وراكبا ((روى البخاري و مسلم . و زاد مسلم)): يصلي فيه ركعتين))

“Profeti ﷺ vinte çdo javë (çdo të shtunë) në xhaminë Kuba, në këmbë dhe hipur mbi kafshë.” [Buhariu dhe Muslimi]

Ka shtuar Muslimi: “Dhe falte dy rekate.”

Shejkh Abdur-Rezzak el Bedr thotë: “S’ka problem nëse shkon më shumë se një herë gjatë javës.”

Shejkh Bin Bazi, Feuzani, Suhejmi thonë: “Më e mira është një herë në javë. Kjo është prej sunnetit.”

Çfarë dite pëlqehet të shkohet në xhaminë Kuba?

Ka mospajtim:

Shumica thonë dita e shtunë, siç përmendet në hadithin e Ibn Umerit.

Një pjesë thonë: “Nuk është për qëllim e shtuna si ditë, por java, sepse në gjuhën e arabëve kur thua "çdo të shtunë" dmth: çdo javë.

Një pjesë thonë: “Profeti ka zgjedhur ditën e shtunë, jo si ditë të veçantë, por për shkak që të njihet me gjendjen e Ensarëve në Kuba të cilët mungonin ditën e xhuma.”

Kete mendim e përkrah shejkh Albani, siç e përmend në [Themerul Mustetab 2/ 570]

All-llahu e di më së miri.

VIZITA E VARREZAVE TE BAKIA-S

Vizita e varreve në përgjithësi është e pëlqyer. Profeti ﷺ thotë:

((زوروا القبور فإنها تذكركم الآخرة)).

“Vizitoni varrezat, sepse ato ju kujtojnë ahiretin.” [Ibn Maxhe. Albani thotë Sahih]

Thotë Shejkh Bin Bazi:

زيارة القبور سنة.

"Vizita e varreve është sunnet"

Pëlqehet vizita e varreve të Baki-as. Thotë Bin Bazi:

يسن له زيارة قبور البقيع و قبور الشهداء و قبر حمزة رضي الله عنه.

"Është e pëlqyer (sunnet) vizita e varreve të Baki-as dhe varreve të dëshmorëve të Uhudit dhe e varrit të Hamzait radiAll-llahu anhu."

Profeti ﷺ i vizitonte varret e Baki -as shpesh, dhe lutej për ata.

Thotë Aisheh radiAll-llahu anhe:

((كان رسول الله -- صلى الله عليه وسلم-- كلما كان ليلتها من رسول الله -- صلى الله عليه وسلم-- يخرج من آخر الليل الى البقيع))

"I Dërguari i All-llahut ﷺ sa herë që kishte rradhën te Aisheh, dilte në pjesën e fundit të natës te varret e Baki-as (lutej për ata)."

Duaja e Varrezave

السلام عليكم أهل الديار من المؤمنين و المسلمين و إنا إن شاء الله بكم للاحقون، أسأل الله لنا و لكم العافاة.

ES-SELAMU ALEJKUM EHLED-DIJAARI MINEL MU'MININE UEL MUSLIMIN

UE INNA INSHA ALL-LLAHU BIKUM LAHIKUN.

ES'ELULL-LLAHE LENA UE LEKUMUL AAFIJEH.

"Es-selemu alejkum o banorë të këtyre varreve prej besimtarëve dhe muslimanëve. Edhe ne insha All-llahu do ju bashkangjitemi. E lus All-llahun për ne dhe për ju të na fale."

Kur të vizitosh varrezat e Bakia-s shton:

ALL-LLAHUMME GFIR LI EHLIL BEKIË.

"O All-llah fal banorët (të vdekurit) e Baki-as."

Ai që nuk e thotë dot në arabisht, le t'a thote në shqip, ska problem.

Vizita e varreve të Baki-es nuk ka kohë të përcaktuar. Kur të mundesh.

Duhet të kemi kujdes sepse varrezat e Baki-as nuk janë hapur në çdo kohë. Shteti ka vendosur orar për vizitën e varreve të Baki-as.

Kujdes gjatë vizitës së Bakia-s.

- Të ecim me qetësi.
- Mos të shtyjme.

- Mos t'i pengojmë të tjerët.
- Mos të bëjmë muhabet.
- Mos të bëjmë foto dhe as video.
- Të meditojmë, të përkujtojmë vdekjen dhe botën tjetër.
- T'i respektojmë rregullat e përcaktuara nga përgjegjësit e saj.
- Mos të ndalemi te ndonjë varr i veçantë me mendimin se është varri i filan Sahabiu.

Nuk ka asnjë dëshmi të sigurtë se filan varr është varri i filan Sahabiut, apo varri i Fatimes, apo varri i Hasanit, nipit të Profetit ﷺ etj...

Të gjitha ç'farë thuhet janë pretendime boshe pa asnjë dëshmi të sigurtë.

Edhe disa varre që i shohim si të ndara, me mendimin se janë varre të sahabëve të njohur, apo të familjes së Profetit, nuk është e vërtetë që janë të tyre. Nuk ka asnjë dëshmi dhe asnjë fakt që e dëshmon këtë.

Disa dijetarë (prej tyre Ibn Uthejmini) thonë se varri i Uthmanit dihet dhe është i njohur. Ndërsa shumë të tjerë thonë: "Nuk dihet asnjë varr i ndonjë Sahabiu."

All-llahu e di më së miri.

Vizita e varreve të dëshmorëve të Uhudit

Pëlqehet vizita e varreve të dëshmorëve të Uhudit. Thotë Imam Neueuiju:

و يستحب ان يزور قبور الشهداء بأحد

"Pëlqehet të vizitohen varret e dëshmorëve në Uhud"

Thotë Ibn Uthejmini:

يَسُنُّ أَنْ يَخْرُجَ إِلَى أَحَدٍ لِيُزِيرَ قُبُورَ الشَّهَدَاءِ

"Është e pëlqyer (sunnat) të shkoj në Uhud, që të vizitoj dëshmorët e Uhudit."

Thuhet e njëjta dua që thuhet në varreza. [Feuzani]

KËTO PESË VENDE PËLQEHET TË VIZITOHEN NË MEDINE DHE JO VENDE TË TJERA.

1. **Xhamia e Profetit ﷺ** e cila është qëllimi i udhëtimit për të vizituar Medinen. Xhamia e Profetit është vendi ku përqëndrohemi gjatë gjithë kohës që jemi në Medine për të falur namazet në të dhe adhurime të tjera.
2. **Vizita e varrit të Profetit ﷺ.**
3. **Vizita e Xhamisë Kuba.**
4. **Vizita e varreve të Baki-as.**
5. **Vizita e varreve të dëshmorëve të Uhudit.**

Përveç këtyre nuk vizitohet asgjë tjetër.

Thotë Shejkh Ibn Utthejmini:

ليس هناك شيء يزار في المدينة سوى هذه ؛ زيارة المسجد النبوي، زيارة قبر النبي ، زيارة البقيع، زيارة شهداء أحد، زيارة مسجد قباء، ما عدا ذلك من المزارات فإنه لا أصل له.

"Nuk ka diçka që vizitohet në Medine përpos këtyre:

- *Vizita e Xhamisë së Profetit ﷺ.*
- *Vizita e varrit të Profetit ﷺ.*
- *Vizita e Bakia-s.*
- *Vizita e dëshmorëve të Uhudit.*
- *Vizita e xhamisë Kuba.*

Përpos këtyre, vendet tjera që vizitohen (nga njerëzit që nuk kanë dije) nuk kanë bazë." [Fikhul Ibaadeet]

Thotë Ibn Tejmije:

لهذا لم يستحب علماء السلف من أهل المدينة و غيرها قصد شيء من المزارات التي بالمدينة و ما حولها بعد مسجد النبي إلا مسجد قباء لأن النبي صلى الله عليه وسلم لم يقصد مسجد بعينه يذهب إليه إلا هو.

"Dijetarët e selefit prej banorëve të Medines dhe vendeve tjera, nuk e konsideronin të pëlqyer të vizitohen ato vende që vizitohen në Medine dhe përreth saj (ata që nuk kanë dije), përpos xhamisë Kuba, sepse Profeti ﷺ nuk ka synuar një xhami të veçantë për të shkuar atje (për t'a vizituar) përpos xhamisë Kuba."

Thotë Bin Bazi:

أما المساجد السبعة و مسجد القبلتين و غيرها من المواضع التي يذكر بعض المؤلفين في المناسك زيارتها فلا أصل لذلك و لا دليل عليه و المشروع للمؤمن دائما هو الاتباع دون الابتداع.

[فتاوى اسلامية]

"Sa i përket shtatë xhamive dhe xhamisë Kibletejni, e të tjera vende të cilat i përmendin disa autorë të cilët kanë shkruar në lidhje me ritet (e Haxhit dhe Umres) se është mirë të vizitohen, nuk ka bazë dhe nuk ka argument.

Ajo që është e ligjësuar për besimtarin gjithmonë është pasimi (i Profetit dhe shokëve të tij) dhe jo shpikjet (bidatet)." [Fetewa Islamijeh 2/313]

SA KOHË ËSHTË MIRË TË QËNDROHET NË MEDINE?

Qëndrimi i vizitorit në Medine nuk lidhet me kohë të caktuar. Thotë Bin Bazi:

و الزيادة ليس لها حد محدود ، و إذا زار ساعة أو ساعتين أو يوماً أو يومين أو أكثر من ذلك فلا بأس

"Vizita (në Medine) nuk ka kufi kohorë të përcaktuar. Nëse e viziton një orë apo dy orë, një ditë apo dy ditë apo më shumë, ska problem."

Shejkh Feuzani thotë: *"Nuk ka kufinj kohorë se sa me qëndru në Medine."*

Qëndrimi në Medine tetë ditë për të falur dyzet namaze në xhaminë e Profetit ﷺ

Disa mendojnë se është mirë me qëndru tetë ditë në Medine, që të falësh dyzet namaze në xhaminë e Profetit ﷺ duke u bazuar në një hadith:

((من صلى في مسجدي أربعين صلاة لا يفوته صلاة كتبت له براءة من النار و نجاة من العذاب و برئ من النفاق))

"Kush fal në xhaminë time dyzet namaze, duke mos i kaluar asnjë namaz (në xhami), i shkruhet atij distancim (largim) prej zjarrit, shpëtim nga ndëshkimi, si dhe largim (dhe pastrim) prej hipokrizisë."

Këtë hadith e konsideron të dobët shejkh Albani, siç e përmend në [Silsiletud- Daifeh 364] dhe në [Daifut-Tergib 755].

Shejkh Bin Bazi thotë:

....إلا أنه حديث ضعيف عند أهل التحقيق لا تقوم به الحجة و لا يعتمد عليه و الزيارة ليس لها حد محدود

"Hadithi është i dobët në gjykimin e dijetarëve të cilët vërtetojnë hadithet, nuk merret për argument, dhe nuk lejohet të bazohemi në të. Vizita nuk ka kufi kohorë të përcaktuar.."

[Fetawa Ibn Baz 17/406] & [Fetawa Islamiyyeh 2/313]

Kështu thotë edhe shejkh Feuzani.

Shejkh Albani e konsideron bidat këtë gjë, siç e përmend në librin e tij [Haxh-xhetun Nebijj 185]:

من بدع زيارة المدينة النبوية "التزام زوار المدينة الإقامة فيها أسبوعاً حتى يتمكنوا من الصلاة في المسجد النبوي أربعين صلاة ، لتكتب لهم براءة من النفاق وبراءة من النار"

----- e pa përkthyer -----

Hadithi i saktë në lidhje me këtë është:

“Kush fal dyzet ditë namazet në xhami, duke mos i ikur tek biri fillestar, i shkruhen dy largime (Dmth: largohet, pastrohet dhe shpëton nga dy gjëra):

1. Largim (pastrim dhe shpëtim) nga zjarri.
2. Largim (pastrim dhe shpëtim) nga hipokrizia.”

[Tirmidhiu / Albani thotë hadith Hasen]

Shkuarja në Medine pas haxhit dhe qëndrimi aty, nuk është prej riteve të Haxhit

Disa mendojnë se shkuarja dhe qëndrimi në Medine pas mbarimit të Haxhit është prej riteve të Haxhit dhe plotësimit të tij.

Ky mendim dhe pretendim nuk ka bazë, nuk ka argument.

Shejkh Feuzani në lidhje me këtë thotë:

لا علاقة بزيارة المسجد النبوي، لا علاقة لها بالحج.

"Nuk ka lidhje (Haxhi) me vizitën e xhamisë së Profetit ﷺ. Nuk ka lidhje (vizita e xhamisë Profetike) me Haxhin"

Eshte pyetur shejkh Bin Bazi në lidhje me këtë dhe ka thënë:

هذا غلط، ليس من شرط الحج ولا من واجباته ولا من سننه زيارة المدينة.

"Kjo është gabim! Vizita e Medines nuk është prej kushteve të Haxhit, as prej obligimeve të Haxhit dhe as prej sunneteve të Haxhit (dmth: prej gjërave që pëlqehen)."

Shejkh Albani në librin e tij [Haxhi i Profetit] këtë pretendim e konsideron Bidat.

Kjo që thotë shejkh Albani, pa dyshim që është e vërtetë.

All-llahu e di më së miri.

Ai është më i dijsmi.

و صلى الله على نبينا محمد وعلى آله وصحبه وسلم.